



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 334/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.05.2018 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “2AT” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-43707-02-05-2018, me objekt “*Blerje kimikate, për UKT sh.a.*”, me fond limit 89.795.578 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 01.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “W.Center” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“2 AT” sh.p.k.
Rruga Korçë - Dishnicë, Km.1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.
Rruga “5 Maj”, pranq Medresesë, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoj relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.02.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-43707-02-05-2018, me objekt “Blerje kimikate, për UKT sh.a.”, me fond limit 89.795.578 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 01.03.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|------------------------------|-----------------------------------|
| 1. “2 AT” sh.p.k. | 46.837.500 lekë, skualifikuar |
| 2. “Dimex” sh.p.k. | 50.756.250 lekë, skualifikuar |
| 3. “Atlantik - 3” sh.p.k. | 58.500.000 lekë, skualifikuar |
| 4. “W. Center” sh.p.k. | 83.928.750 lekë, kualifikuar |
| 5. “2 - MJ” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 6. “T & M Chemicals” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 06.03.2018 operatori ekonomik “2 AT” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

- Së pari, AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Për plotësimin e kriterit për shlyerjen e energjisë elektrike, shoqëria “2 AT” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm në portalin elektronik të APP-së për këtë procedurë prokurimi: “Vërtetim debie” nr. 132 prot, datë 26.02.2018, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “2-AT” sh.p.k, ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me Kod KR0A0602260028118 KR0D060001628438... rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 26.02.2018 pa përfshirë faturën koherente të muajit Janar 2018”.

Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Janar 2018.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “2-AT” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “dh” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se: “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 06.02.2018 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 01.03.2018 brenda këtij afati operatori ekonomik e kishte detyrim të kishte bërë pagesën e faturës së muajit Janar 2018 si dhe të pajisej me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe

pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë” Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- Së dyti Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit/ në pikën 1 si më poshtë cituar: Ofertuesi duhet të deklarojë se:
 - a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv) b) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP, c) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur. Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Operatori ekonomik në Sistemin elektronik të app-së ka paraqitur shtojcën 8 “Deklaratë mbi gjendjen Gjyqësore” ku ndër të tjera ka deklaruar se operatori ekonomik “2- AT” sh.p.k nuk është i dënua për shkelje penale, si dhe nuk është i dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë. Komisioni i vlerësimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur për përmbushjen e pikës 1 të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit gjykon se nuk ka paraqitur dokumentacion sipas setit të DST që APP ka publikuar në web app.gov.al dhe që janë detyruara për zbatim nga cdo AK në procedurat e vitit 2018 e në vijim . Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 41, pika 1, ku parashikohet se:

“Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike”, si edhe Seksionit II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 1.1. të dokumentave të tenderit ku është përcaktuar: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT.

Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”, KVO vlereson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori “2- AT” shpk nuk është i saktë dhe sipas dokumentave të cilat janë aktualisht në fuqi. Dokumentet e tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ia vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit e si rrjedhojë edhe operatorët ekonomikë duhet të përdorin këto dokumenta. Rrjedhimisht, që nga data kur ka hyrë në fuqi e është publikura vendimi I APP për miratimin e DST për vitin 2018, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit të dokumentave standarde të tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe rrjedhimisht, operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë të detyruar të plotësojnë këto dokumenta.

KVO konstaton gjithashtu se, nuk jemi në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Prandaj, “2 AT” sh.p.k duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

II.4. Në datën 12.03.2018 operatori ekonomik “2 AT” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij si edhe duke ngritur pretendime në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik W. Center.

Konkretisht, operatori ekonomik ankimes pretendon si më poshtë vijon:

Ne datën 06/03/2018 jemi njohur me klasifikimin e Operatoreve për tenderin e zhvilluar në datë 01.03.2018 nga Autoriteti Kontraktor Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Tiranë me objekt “Blerje kimikate, për UKT sha” me fond limit 89,795.578 (tetëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) leke pa TVSH ku firma “2 AT” Shpk është skualifikuar për dokumentat e mëposhtme:

Nga ana e KVO është vlerësuar se firma 2 AT Shpk nuk ka plotësuar dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit duke pretenduar se :

- a. Nuk ka të deklaruar se firma 2 AT shpk nuk është e regjistruar në QKB për objektin e tenderimit Blerje Kimikate*
- b. Nuk ka deklaruar se firma 2 AT Shpk nuk është në proces falimentimi*
- c. Nuk ka deklaruar pagimin e të gjitha detyrimeve për pagimin e tatimeve e të kontributve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

Te gjitha këto vlerësime nga ana e KVO nuk qendrojnë.

- a. Në dokumentat e tenderit firma 2 AT Shpk ka paraqitur sipas ligjit Ekstraktin e thjeshtë dhe historik të firmes. Në ekstraktin historik të firmes 2 AT Shpk në pikën 9 ku shprehet objekti i aktivitetit të firmes 2 AT shkruhet shprehimisht :*

Objekti i aktivitetit : Veprimtari ne fushen e prodhimit , tregtimit te detergjenteve , bojrave te te gjitha llojeve , Ilakeve , reagenteve te thjeshte , veprimtari laboratorike ne fushen e mjedisit, produkteve ushqimore , ujit te pijshem , tregtim me pakice e shumice te artikujve industriale, ushqimore, bujqesore, blektorale, kimikate, material e ndertimi, bar, bufë, restorante, hoteleri, veprimtari transporti.

Prodhim i dizinfektanteve per trajtimin e ujit te pijshem .Hipoklorit Natriumi. Tregtim i karbonit aktiv pluhur per trajtimin e ujit te pijshem.

Pretendimi i KVO per piken a eshte i padrejte .

- b. Ne ekstraktin e firmes 2 AT ne piken 17 Statusi i firmes 2 AT Shpk eshte aktiv dmth qe nuk eshte ne proces falimentimi.

Edhe ky pretendim i KVO eshte i pabazuar.

- c. Pretendimi i KVO se firma 2 AT Shpk nuk ka deklaruar pagimin e te gjitha detyrimeve per pagimin e tatimeve e te kontributeve sigurimeve shoqerore , sipas legjislacionit ne fuqi ne dokumentat e dorezuar nga firma 2 AT Shpk eshte dorezuar Vertetimi nr. T00142678 Date 22.02.2018 per pagimin e Kontributeve e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore per Tatimpaguesin E -SIG 02/a dhe Nr. T00142674 date 22.02.2018 Vertetim per pagim detyrimesh.

Pretendimi i KVO dhe per kete pike nuk qendron

2. KVO ka skualifikuar firmen 2 AT Shpk me pretendimin se nuk ka shlyer detyrimet e Energjise elektrike .

Firma 2 AT Shpk ne dokumentat e parqitura ne tender ka dorezuar Vertetim e Debise Nr. 132 Prot date 26/02/2018 ku shprehet qarte se firma 2 AT Shpk rezulton te kete 0 lek detyrime per faturat e energjise elektrike , vlere e llogaritur deri ne daten 26.02.2018 , pa perfshire faturen koherente te muajit Janar 2018.

OSHEE eshte institucioni ligjor shteteror qe ka te drejte te vleresoje detyrimet e firmes 2 AT Shpk per energjiine elektrike dhe KVO nuk ka te drejte te interpretoje nje dokument ligjor dhe shteteror por ka vetem te drejten e verifikimit te ketij dokumenti.

Pretendimi se firma 2 AT Shpk nuk ka paguar detyrimet per muajin Janar 2018 te energjise elektrike nuk qendron.

- a. Ne faturen koherente te muajit Janar 2018 ne reshtin totali per t'u paguar shkruhet afati i pageses 28.02.2018. Firma 2 AT Shpk duke zbatuar ligjin dhe korrektesine e pagese se kesaj fature ne daten 27.02.2018 ka bere pagesen e muajit Janar 2018 prane OSHEE te dyja keto dokumentajane te bashkangjitura ne kete ankse .

Pretendimi i K VO skualifikon pa te drejte firmen 2 AT Shpk per pagimin e energjise elektrike nuk qendron .

Duke u bazuar ne Nenin 53 mund ti kerkonte firmes 2 AT shpk sqarime per detajet e mesiperme ose per interesin publik te bente verifikimin ne portali e-Albania dhe nga OSHEE.

3. Firma 2 AT Shpk ju ve ne dijeni se per kete procedure prokurumi nuk ka autorizuar asnje nga firmat pjesemarese te paraqese dokumenta teknike ose cfaredolloj dokumenta te firmes 2 AT Shpk si dhe dokumentat te firmes Giormani B LTD Selanik -Greqi (e cila ka autorizuar vetem firmen 2 AT Shpk te paraqese dokumenta nga firma Giormani B LTD ne kete prokurim publik)

Ne dijenine tone firmat ofertuese ne kete tender kane perdorur dokumentatcionin e firmes 2 AT Shpk te pautorizuar dhe ka dyshime te mjaftueshme qe ato jane dhe te falsifikuara per kete qellim ne baze

te nenit 21 te Ligjit te Prokurimeve Publike kerkojme te dime mbi perdorimin e dokumentave te firmes 2 AT Shpk dhe Giormani B LTD ne kete prokurim.

KVO ka kryer nje kualifikim te padrejte ne kete procedure te firmes W. Center Shpk e cila nuk ploteson dokumentat standarte te tenderit shtojca 9 pika 2.3 Kapaciteti teknik

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese:

Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me objektin e prokurimit për mallin e kërkuar. Ne rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet te paraqesi Certifikaten e prodhuesit qe verteton konformitetin e produktit ne prokurim me normat Europiane (EN;883;2006) dhe (EN 939;2009) dhe (EN 901;2013) Produkte kimike per tregetimin e produkteve per trajnimin e ujit te destinuar per konsum njerezor, konform normave europiane.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje certifikate Nr.Reach te prodhuesit i cili verteton se prodhuesi“) eshte i regjistruar dhe i certifikuar per tregtimin e produkteve kimike per trajtimin e ujit per konsum njerezor ue komunitetin Europian.

2.3.11 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe një drejtues mjete.

Për punonjësin “Kimist” dokumentat që duhet të paraqes janë: diplomë, CV dhe kontratë pune (e vlefshme per të paktën periudhën e parashikuar) si dhe të figurojë në listpagesa e shoqerisë.

Për punonjësin “Drejtues mjete” dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe të figurojë në listpagesat e shoqerisë.

2.3.12 Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose qera mjetin tip “Bot” ose cistern të çertitikuara për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE.

Firma W. Center Shpk per plotesimin e ketyre pikave ka paraqitur dokumenta te pasakta dhe te dyshimta ne origjinalitetin e tyre .

Kerkojme nga K VO ne baze te nenit 21 E drejta per informim e LIGJIT Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr. “) 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 dhe Ligjin Nr. 47/2017

Informacion per keto dokumenta.

4. Firma 2 AT Shpk konkludon se KVO ka skualifikuar ne menyren me skandaloze te mundshme firmen 2 AT, KVO nuk ka marre parsysh anen financiare te ketij prokurimi i cili do t'i sillte institucionit nje kursim prej 37,091,25 0 lek por eshte bere pale (ortake) e kesaj afere korruptive dhe abuzive qe po behet ne Sha UK T ne te gjitha tenderata e kimikateve.

Per sa u thame me siper firma 2 AT Shpk do ta vertetoje me dokumenta te padiskutueshme dhe origjinale prane organeve ligj zbatuese , mediave dhe institucioneve te luftes kunder korrupsionit shperdorimit te qindra milion lek ne prokurimet publike per Blerje kimikatesh dhe Karbon Aktiv ne Sha Uk Tirane.

II.5. Operatori ekonomik sqaron se në datën 12.03.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 8534/1 prot., datë 12.03.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar ankesën.

Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton se: *Operatori ekonomik ka kontestuar ne ankesen paraqitur prane Autoritetit Kontraktor te 2 arsyet e skualifikimit per te cilat pranon ne ankesen depozituar prej tij qe jane mangesi qe ekzistojne por qe nuk duhet te merreshin parasysh nga ana e KVO-së.*

Komisioni i shqyrtimit te ankesave pasi morri ne shqyrtim dokumentacionin e Operatorit Ekonomik "2 AT" shpk konstaton se:

1. *Shoqëria "2AT" shpk konteston vendimin për skualifikim nga ana e KVO-së lidhur me mosparaqitjen e deklaratës lidhur me objektin, deklaratës se nuk është e rregjistruar në QKB, deklaratës se nuk është në proces falimentimi si dhe deklaratën e pagesës së shlyerjes së detyrimeve e tatimeve dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore.*

KSHA konstaton se, KVO në pretendimet e veta të skualifikimit të operatorit ekonomik të mësipërm nuk është shprehur se operatori ekonomik "2 AT" shpk nuk ka paraqitur dokumentat e mësipërm por komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik të APP-së për përmbushjen e pikës 1 të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit ka gjykuar se shoqëria ankimuese nuk ka paraqitur dokumentacion sipas setit të DST qe APP ka publikuar ne web app.gov.al dhe qe jane detyruara per zbatim nga cdo AK ne procedurat e vitit 2018 e ne vijim, konkretisht operatori ekonomik nuk ka paraqitur shtojcën nr 8.

KSHA gjykon se Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 41, pika 1, në të cilin parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion l'alas në rrugë elektronike", si edhe Seksionit II "Udhëzime për operatorët ekonomikë", pika 1.1. të dokumentave të tenderit ku është përcaktuar:

"Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DST. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DST dotë refuzohen sitë papranueshme", KSHA sqaron se : Dokumentet e tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ia vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave.

Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarte të tenderit e për rrjedhojë edhe Operatorët ekonomikë duhet të përdorin këto dokumenta.

Nga data kur ka hyrë në fuqi dhe eshte publikura vendimi i APP për miratimin e DST per vitin 2018, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit të dokumentave standarde të tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe rrjedhimsht, operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë të detyruar të plotësojnë këto dokumenta.

KSHA konstaton gjithashtu se, nuk jemi në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar.

Prandaj, shoqëria ankimuese "2 AT" sh.p.k duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

KSHA vlereson se në dokumentacionin që operatori “2AT” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik të app-së mungon shtojca 8 dhe sa më sipër cituar pretendimi i shoqërisë ankimuese lidhur me këtë pikë gjykojmë se nuk qëndron pasi nuk është paraqitur sipas dokumentave të cilat janë aktualisht në fuqi.

Shoqëria “2AT” shpk konteston vendimin për skualifikim nga ana e KVO-së lidhur me mospërfshirjen e pagesës së energjisë për muajin janar, sqarojmë se publikimi i procedurës objekt ankimi në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 6.02.2018 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 01.03.2018 brenda këtij afati operatori ekonomik e kishte detyrim të kishte bërë pagesën e faturës së muajit janar si dhe të paisej me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjike elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Nga interpretimi që i bëhet kriterit të mësipërm si dhe bazës ligjore referuar konstatojmë se AK ka vepruar drejt kur ka skualifikuar operatorin ekonomik pasi muaji janar konsiderohet si detyrim i maturuar i energjisë si dhe afati i fundit i pagesës së këtij detyrimi është data 28.02.2018.

Operatori Ekonomik mund ta kontestonte këtë kriter të vendosur nga AK në mbështetje të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 78 “Ankesat në autoritetin kontraktor”, ligjvënësi ka parashikuar ankimin për dokumentat e tenderit, pra operatori ekonomik ka patur mundësi të ankimohet për dokumentat e tenderit para hapjes së procedurës së prokurimit.

Pjesëmarrja e tij në këtë procedurë dhe paraqitja e ofertës nga ana e shoqërisë presupozon që ka marrë parasysh të përbushë të gjitha kriteret që Autoriteti Kontraktor i vlerëson të nevojshme për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese . Këto kriter të vendosura nga ana e autoritet kontraktor dhe kriteri në fjalë është vendosur në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “e” ku ndër të tjera citohet se:

“Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Nuk janë kontestuar nga ana e operatorit ekonomik pra janë konsideruar nga ana e këtij operatori si kriter ne përputhje të plotë me ligjin dhe aktet nenligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese në lidhje me plotësimin e kriterëve të veçanta për kualifikim nuk qëndron dhe komisioni i shqyrtimit të ankësave vendos të lërë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Kimikate për UKT sha”

KSHA së treti ka shqyrtuar pretendimet e shoqërisë ankimuese lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik i kualifikuar në këtë procedurë d/te konkludoi se pretendimet nuk qëndrojnë. Duke qënë se barra e provës bie mbi shoqërinë ankimuese pretendimet e ngritura nga ana e tij duhet të shoqërohen me fakte dhe prova konkrete për të bazuar kontestimet e bëra mbi ofertën e operatorit ekonomik W-Center .

Pra te dyja keto arsye te konstatuara nga komisioni i vleresimit të ofertave qendrojnë. KSHA nuk i konsideron devijime te vogla pasi devijime te vogla ne kuptim te ligjit janë devijime te argumentuara mosparaqitja e nje dokumenti nga ana Juaj ne formen e sakte te kerkuar nga ligji nuk mund te konsiderohet devijim i vogel.

Sa me siper në mbështetje të nenit 53 pika 3 e ligjit Nr 9643 dt 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikohet se: “Autoriteti Kontraktor vlerëson një ofertë të“ vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit ” si edhe në mbështetje të VKM Nr.914 dt 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VII, Neni 66 pika 3 ku citohet se: “Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit..... ”.

Pra referuar ligjit dhe akteve nënligjore ne fuqi, operatori ekonomik duhet te paraqiste vertetimin e debise si dhe shtojcën 8 sipas modelit të përcaktuar në dokumentat standarte te tenderit pra ne formën e sakte referuar dokumentave standarte te tenderit dhe akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

II.6. Në datën 19.03.2018 operatori ekonomik “2 AT” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në autoritetin kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. K-1528/1 Prot., datë 24.03.2018, protokolluar me tonën në datën 26.03.2018 me objekt “Informacion i hollësishëm mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kimikate për UKT sha”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “2 AT” sh.p.k, mbi skualifikimin e tij për arsyen që lidhet me vërtetimin e lëshuar nga OSHEE, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, gërma “d”, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: “d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues të depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton që në përmbushje të këtij kriteri, ankimuesi ka paraqitur:

- *“Vërtetim debie” nr.132 Prot, datë 26.02.2018, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, ku evidentohet që: “...nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën/kontratën (me kod) [...], titular i së cilës/cilave është 2 AT sh.p.k., rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 26.02.2018, pa përfshirë faturën koherente të muajit Janar 2018”.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.*

III.1.4. Në nenin 27, pika 5, gërma “c” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.*

III.1.5. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE-s, nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar”.*

III.1.6. Për sa mësipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori “2 AT” sh.p.k, nuk e plotëson kriterin e lartpërmendur të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi procedura e prokurimit në fjalë është publikuar në datën 06.2.2018, dhe është zhvilluar (hapja dhe dorëzimi i ofertave), në datën 01.03.2018. Rrjedhimisht, operatori ekonomik duhej të kishte paraqitur një dokument që të vërtetonte se i ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, përfshirë edhe detyrimet për muajin Janar 2018, detyrime këto të maturuara (data përfundimtare për shlyerjen e të cilave, mbështetur në nenin e sipërcituar, ishte data 28.02.2018), ndërkohë që vërtetimi që ai ka paraqitur vërteton shlyerjen e detyrimeve deri në muajin Dhjetor 2018 (duke e përfshirë muajin Dhjetor).

III.1.7. Ndërkohë, në ankesën drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik më datë 19.03.2018, operatori ekonomik “2 AT” sh.p.k, ka përcjellë (ndër të tjera) edhe kopjen e dokumentit “Mandat arkëtimi”, të datës 27.02.2018, në të cilin konstatohet kryerja e pagesës së detyrimeve të energjisë elektrike për muajin Janar 2018.

III.1.8. Lidhur me sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson gjithashtu se, autoriteti kontraktor nuk ka qenë në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar.

Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë. Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

III.1.9. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP.

Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “2 AT” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se arsyeja e skualifikimit Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit/ në pikën 1 si më poshtë cituar: Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv) b) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP, c) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur. Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Operatori ekonomik në Sistemin elektronik të app-së ka paraqitur shtojcën 8 “Deklaratë mbi gjendjen Gjyqësore” ku ndër të tjera ka deklaruar se operatori ekonomik “2- AT” sh.p.k nuk është i dënua për shkelje penale, si dhe nuk është i dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë. Komisioni i vlerësimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur për përmbushjen e pikës 1 të kritereve të përgjithshme të kualifikimit gjykon se nuk ka paraqitur dokumentacion sipas setit të DST që APP ka publikuar në web app.gov.al dhe që janë detyruara për zbatim nga cdo AK në procedurat e vitit 2018 e në vijim .

Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 41, pika 1, ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike”, si edhe Seksionit II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 1.1. të dokumentave të tenderit ku është përcaktuar: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT.

Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”, KVO vlereson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori “2- AT” shpk nuk është i saktë dhe sipas dokumentave të cilat janë aktualisht në fuqi. Dokumentet e tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ia vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit e si rrjedhojë edhe operatorët ekonomikë duhet të përdorin këto dokumenta. Rrjedhimisht, që nga data kur ka hyrë në fuqi e është publikuar vendimi i APP për miratimin e DST për vitin 2018, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit të dokumentave standarde të tenderit, të

miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe rrjedhimisht, operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë të detyruar të plotësojnë këto dokumenta.

KVO konstaton gjithashtu se, nuk jemi në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Prandaj “2 AT” sh.p.k duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, pika 2 “Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit”, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: “Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

b) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

c) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër”.

Gjithashtu në dokumentat e tenderit, është përcaktuar edhe Shtojca 8 “Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme”, shtojcë kjo e detyrueshme për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë, e përcaktuar kjo edhe në krye të kësaj shtojce.

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues të depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton që në përmbushje të këtij kriteri, nuk ka paraqitur shtojcën përkatëse të përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe konkretisht Shtojcë 8 “Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme”. Konstatohet se ankimuesi ka paraqitur:

- Shtojca 8 “Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore”;
- Ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjesi të kufizuar”, ku rezulton statusi “Aktiv”;

- Ekstrakti historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, ku rezulton statusi “Aktiv”;
- Vërtetim (për pagim detyrimesh) lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë në datën 22.02.2018, ku rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor i papaguar deri në datën 22.02.2018;
- Vërtetim i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë në datën 22.02.2018 për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin, ku konstatohet se personi juridik “2 AT”, ka për të paguar gjithsej 0 lekë detyrime [...];

III.2.3. Operatori ekonomik ankimues në lidhje me këtë arsye skualifikimi pretendon se:

- a. Ne dokumentat e tenderit firma 2 AT Shpk ka paraqitur sipas ligjit Ekstraktin e thjeshte dhe historik te firmes. Ne ekstrakti historik i firmes 2 AT Shpk ne piken 9 ku shprehet objekti i aktivitetit te firmes 2 AT shkruhet shprehimisht: Objekti i aktivitetit: Veprimtari ne fushen e prodhimit, tregtimit te detergjenteve, bojrave te te gjitha llojeve , Ilakeve, reagenteve te thjeshte, veprimtari laboratorike ne fushen e mjedisit, produkteve ushqimore, ujit te pijshem, tregtim me pakice e shumice te artikujve industriale, ushqimore, bujqesore, blektorale, kimikate, material e ndertimi, bar, bufe, restorante, hoteleri, veprimtari transporti.

Prodhim i dizinfektanteve per trajtimin e ujit te pijshem .Hipoklorit Natriumi. Tregtim i karbonit aktiv pluhur per trajtimin e ujit te pijshem.

Pretendimi i KVO per piken a eshte i padrejte .

- b. Ne ekstraktin e firmes 2 AT ne piken 17 Statusi i firmes 2 AT Shpk eshte aktiv dmth qe nuk eshte ne proces falimentimi.

Edhe ky pretendim i KVO eshte i pabazuar.

- c. Pretendimi i KVO se firma 2 AT Shpk nuk ka deklaruar pagimin e te gjitha detyrimeve per pagimin e tatimeve e te kontributeve te sigurimeve shoqerore , sipas legjislacionit ne fuqi ne dokumentat e dorezuar nga firma 2 AT Shpk eshte dorezuar Vertetimi nr. T00142678 Date 22.02.2018 per pagimin e Kontributeve e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore per Tatimpaguesin E -SIG 02/a dhe Nr. T00142674 date 22.02.2018 Vertetim per pagim detyrimesh.

Pretendimi i KVO dhe per kete pike nuk qendron”.

III.2.4. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, argumenton se: “KSHA konstaton se, KVO në pretendimet e veta të skualifikimit të operatorit ekonomik të mësipërm nuk është shprehur se operatori ekonomik “2 AT” shpk nuk ka paraqitur dokumentat e mësipërm por komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik të APP-së për përmbushjen e pikës 1 të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit ka gjykuar se shoqëria ankimuese nuk ka paraqitur dokumentacion sipas setit të DST që APP ka publikuar në web app.gov.al dhe që janë detyruara për zbatim nga cdo AK në procedurat e vitit 2018 e në vijim, konkretisht operatori ekonomik nuk ka paraqitur shtojcën nr 8.

KSHA gjykon se Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik“, i ndryshuar, neni 41, pika 1, në të cilin parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion l'alas në rrugë elektronike”, si edhe Seksionit II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 1.1. të dokumentave të tenderit ku është përcaktuar: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DST. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DST dotë refuzohen sitë papranueshme“, KSHA sqaron se:

Dokumentet e tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ia vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarte të tenderit e për rrjedhojë edhe Operatorët ekonomikë duhet të përdorin këto dokumenta.

Nga data kur ka hyrë në fuqi dhe është publikura vendimi i APP për miratimin e DST për vitin 2018, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit të dokumentave standarde të tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe rrjedhimsht, operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë të detyruar të plotësojnë këto dokumenta.

KSHA konstaton gjithashtu se, nuk jemi në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Prandaj, shoqëria ankimuese “2 AT” sh.p.k duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti konti-aktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. KSHA vlereson se në dokumentacionin që operatori “2AT” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik të app-së mungon shtojca 8 dhe sa më sipër cituar pretendimi i shoqërisë ankimuese lidhur me këtë pikë gjykojmë se nuk qëndron pasi nuk është paraqitur sipas dokumentave të cilat janë aktualisht në fuqi”.

III.2.5. Në nenin 41, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike”.

III.2.6. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

III.2.7. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 10, përcaktohet shprehimisht se: “APP-ja përgatit formatin e dokumenteve standarde të tenderit, që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit. Këto dokumente japin informacion që ka lidhje me objektin e kontratës dhe llojin e procedurës, i cili plotësohet, në çdo rast, nga autoritetet kontraktore. Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor përdor dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike ose kundrejt pagesës, në rastet kur vlerësohet nga autoriteti kontraktor në procedurat e prokurimit që nuk kërkojnë njoftim publik, sipas nenit 38 të LPP. Në çdo rast, emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij duhet të mbahen sekret”.

III.2.8. Në dokumentat e tenderit, Seksioni II Udhëzime për operatorët ekonomikë, Seksioni 1 Hartimi i ofertës, në pikën 1.1. është përcaktuar se:

“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është paraqitur dokumentacioni sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e reja të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik me vendimin nr. 01, datë 10.01.2018 dhe konkretisht ka një mungesë fizike të dokumentit *Shtojca 8: Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme*. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin në lidhje me ekstraktin e QKR, vërtetimin nga ana e organeve tatimore, shtojcën 8 Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore, dokumentat këto të gjitha sipas setit të vjetër të dokumentave standarte të tenderit, ndërkohë që nuk është paraqitur Shtojca 8: Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, e cila për më tepër është një dokument deklarativ lehtësisht i plotësueshëm nga ana e operatorit ekonomik.

Ashtu siç edhe autoriteti kontraktor sqaron, gjykojmë se nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është paraqitur dokumentacion në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si edhe në dokumentat standarte të tenderit të hartuara dhe miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje në thelb me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike Shtojcën 8 sipas setit të dokumentave të tenderit të cilat janë aktualisht në fuqi.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “W. Center” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.3.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.*

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtuara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërisht nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “2 AT” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-43707-02-05-2018, me objekt “Blerje kimikate, për UKT sh.a.”, me fond limit 89.795.578 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 01.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 537 Protokolli

Datë 19.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi